

## **Hapet thirrja për bursa për stafin akademik të Universitetit të Tiranës në kuadër të Programit Erasmus + në Universitetin e Humboldt-Universität zu Berlin, në Gjermani**

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për stafin akademik të Universitetit të Tiranës në Universitetin e Humboldt-Universität zu Berlin, në Gjermani, për semestrin e dytë të vitit akademik 2016-2017.

### **Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

- Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie;

### **Kohëzagjatja e bursave:**

- 5 ditë (plus 2 ditë udhëtim). Mobiliteti duhet të kryet deri në muajin korrik 2017.

### **Fushat e studimit:**

- Shkenca Humane;
- Gjuhë të Huaja dhe Shkenca Filologjike;
- Histori;

### **Bursat përfshijnë:**

- Kompensimin ditor (120 EUR në ditë)
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të originës)

<b>DISTANCA E UDHËTIMIT</b> ( <a href="http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm">http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm</a> )	<b>Kompensimi</b>
<b>Midis 100 dhe 499 KM</b>	180 EUR
<b>Midis 500 dhe 1999 KM</b>	275 EUR
<b>Midis 2000 dhe 2999 KM</b>	360 EUR
<b>Midis 3000 dhe 3999 KM</b>	530 EUR
<b>Midis 4000 dhe 7999 KM</b>	820 EUR
<b>8000 KM ose më shumë</b>	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni në këtë link:

[http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)

Dokumentat e nevojshme për aplikim **për stafin akademik për mësimdhënie:**

- CV+ lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Dokumenti i aplikimit që mund ta shkarkoni në adresën:  
[https://www.slawistik.hu-berlin.de/de/member/wassersf/erasmus/e-application-form-for-mobility-grant-new.pdf/at\\_download/file](https://www.slawistik.hu-berlin.de/de/member/wassersf/erasmus/e-application-form-for-mobility-grant-new.pdf/at_download/file)
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);
- Letër ftese nga Universiteti Pritës;
- Certifikata e gjuhës së huaj (që vërteton njohuritë e gjuhës angleze ose gjermane në nivelin B1 në varësi të programit të mësimdhënies);
- Plani i mobilitetit për mësimdhënie\*;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Mësimdhënie klikoni në adresën:

[https://www.slawistik.hu-berlin.de/de/member/wassersf/erasmus/staff-teaching-mobility-agreement.doc/at\\_download/file](https://www.slawistik.hu-berlin.de/de/member/wassersf/erasmus/staff-teaching-mobility-agreement.doc/at_download/file)

*\*Plani i Mobilitetit për stafin akademik është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.*

Afati për aplikim: **12 Qershor 2017**

Për të aplikuar ju lutemi të dorëzoni dokumentat dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Komunikimit, Sektori për Marrëdhëniet me Jashtë dhe të dërgohen njëkohësisht të skanuara në adresën [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al)

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën:  
[iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al)

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!